



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

KOMUNA E KAMENICËS
Zyra e Kryetarit
Nr.02/dt.13/12/2024
Kamenicë.

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



	REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOS
	QENDRA PËR SHËRBYM TË QY CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. <u>02</u>	Nr. <u>38278</u>
U. _____	Br. _____
Nr. i faq. <u>1</u>	Data: <u>16/12</u>
Br. str. _____	Datum: _____
	KAMENICË/A <u>2024</u>

THIRRJE

Për.....nga.....

Kryetari i Komunës, konform dispozitave në fuqi të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, caktoi mbledhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi e cila do të mbahet më **23/12/2024**, më fillim në ora **14.00h.**

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Ndalimi i përdorimit të mjeteve piroteknike në hapësirat publike ;
3. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal në Ndërtesën e Administratës Komunale në Kamenicë.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



PROCESVERBAL

I përpiluar më datë 11/12/2024, me fillim në ora 14:00, në sallën e Kuvendit Komunal në Kamenicë. Prezent janë Kryetari i Komunës z. Kadri Rahimaj me anëtarë të KKSBB-së dhe përfaqësues të KFOR-it, e OSCE .

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Mbrojtja e qytetareve në nevojë për shërbime sociale dhe familjare si mbrojtja dhe ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës në familje deri në integrimin e viktimës;
3. Të ndryshme

Mbledhjen e hapi dhe udhëhoqi z. Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës i cili përshëndeti të pranishmit dhe hodhi në votim rendit e ditës, ku rendi i ditës miratohet nga të gjithë të pranishmit me piken shtesë;

3. 16- Ditë Aktivizimi në baza gjinore;

Pika I

Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës; hedhë në votim procesverbalin i cili miratohet nga të pranishmit në takim.

Pika II

Mbrojtja e qytetareve në nevojë për shërbime sociale dhe familjare si mbrojtja dhe ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës në familje deri në integrimin e viktimës;

Kadri Rahimaj, Kryetari i Komunës së Kamenicës, në piken e dytë e kemi zyrtaren Kimete Kryeziu e cila do të na njoftoi detalisht.

Kimete Kryeziu, zyrtare e QPS-së, Përshëndetje për të pranishmit, Qendra për Punë Sociale, si institucion kompetent për mbrojtje sociale në nivel lokal, ofron shërbime sociale dhe familjare për të gjithë individët dhe familjet në nevojë sociale pa dallim, konform legjislacionin në fuqi. Meqense sot në rend dite është çështja e dhunës në familje, ju informoj se edhe për këtë kategori, QPS ka trajtuar të gjitha rastet e referuara, duke ju ofruar shërbime konform standardeve të punës sociale.

Gjithsejt kemi të evidentuara **29 raste, pejtire 16 viktimafemra dhe 13 meshkuj,**

Sipas nacionalitetit kemi, **21 shqiptar, 7 rom dhe 1 serb.**

Statistikat mund të mos na përputhen me policinë, për arsye se tek ne rasti regjistrohet si klient njherë dhe hapet dosja, dhe edhe nëse përsëritet rasti, brenda vitit nuk regjistrohet për së dyti por vetëm vazhdohet me dhënje të shërbimeve shtesë sipas nevojës, e që kemi edhe raste të tilla të përsëritura, gjithsej **10 raste recidive** (qoftë të këtij viti apo edhe të viteve paraprake.

Të gjitha rastet e paraqitura, janë vizituar, janë dhënë këshilla individuale dhe familjare dhe kemi punuar në sanim të raporteve familjare, pasi jo të gjitha rastet kanë qenë mes bashkëshortëve ose raporte bashkëjetese (10), por shumica kanë qenë në raporte të tjera familjare, **si vëllezër, motra, prind-fëmijë, vjehri-re, etj.**

Te bashkëshortët me fëmijë të mitur QPS jep shërbime edhe të ndërlidhura me gjykatën, duke marrë pjesë në seanca gjyqësore për urdhër mbrojtje dhe dhënë të mendimit për besim të përkohshëm të fëmijëve, organizim dhe ndërmjetësim të kontaktimeve prind-fëmijë, etj.

Këtë vit kemi rritje të numrit të **viktimave meshkuj** dhe rritje të numrit të rasteve nga **nacionaliteti rom.**

Ajo që është më shqetësuese është se nga viti në vit po përsëriten të njëjtat probleme dhe vështirësi dhe nuk po bëhet asgjë në praktik për zgjidhje të tyre, ende kemi mungesë të **strehimit social** për viktime të dhunës, mungon **buxheti** i paraparë për QPS për mbështetje urgjente të viktimave e që e parasheh edhe ligji në fuqi, e më shqetësuesja është **mungesa e kapaciteteve institucionale dhe shërbimeve adekuate për trajtim të kryesve të dhunës, me theks të veçantë kryesit me problem të shëndetit mendor.**

Ne kemi rast konkret që tani e mbi dy vite kryesi i dhunës me probleme mendore e ka të shqiptuar nga gjykata masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor dhe kjo masë asnjëherë nuk është zbatuar nga ana e Institutit të Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë, për shkak të mungesës së kapacitete.

Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës, një lëmi që na shqetëson, asnjë dhunë që ushtrohet nuk mundë të s' shërohet, plaga shërohet mirëpo dhuna është e rëndë uroj QPS-në për punën që po bënë si institucion po kemi bashkë punim me strehimoren "Liria" si strehimore e personave të dhunës në familje.

Nazmi Hoti nga Policia e Kosoves –sektori i hetimeve, rastet e dhunës janë shqetësuese dhe ka arrit numri (30) tri dhjetë të gjitha rastet janë mbyllur vetëm rasti i fundit është i hapur, ne si polici kemi avancuar me pajisje për përcjelljen e personave të dyshimtë të dhunës.

Pika III

16 Ditë aktivizëm kundër dhunës në bazë gjinore

Nazmije Demolli Koordinatorë e njësisë komunale për të drejtat e njeriut, njëherësh Koordinatorë edhe e Mekanizmit Komunal kundër Dhunës në Familje, Nazmije Demolli Kastrati përmendi aktivitetet e realizuara nga kjo njësi në kuadër të fushatës “16 Ditë aktivizëm kundër dhunës në bazë gjinore” Komuna e Kamenicës ka nisur fushatën globale 16 Ditë Aktivizëm Kundër Dhunës me Bazë Gjinore” me një ecje simbolike, pastaj me ftesë të Ministrisë së Drejtësisë morëm pjesë në ceremoninë madhështore të hapjes së fushatës globale “16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore”, poashtu pjesëmarrje në konferencën “Të Bashkuar Kundër Dhunës – Mjaft!”, takimi me Këshillin Komunal të Nxënësve lidhur me fushatën “16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore”, tryeza e rrumbullakët: “Të bashkuar Kundër Dhunës”, u mbajt edhe tryeza e Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje (MKKDF), nën moton “Të bashkuar Kundër Dhunës” dhe sloganin “Sot dhe çdo ditë tjetër”, u organizua takimi “Ndërtimi i një qasjeje të ndjeshme gjinore në identifikimin, referimin dhe trajtimin e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë”, po ashtu edhe takimi Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës në bashkëpunim me Njësinë Komonale për të Drejtat e Njeriut kanë mbajtur takim me temën “Ndërtimi i një qasjeje të ndjeshme gjinore në identifikimin, referimin dhe trajtimin e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë”, është mbajtur punëtorja: “Dhuna ndaj Gruas / Dhuna me Bazë Gjinore” me të rinjtë e komunitetit Rom, po ashtu edhe panairi i grave ndërmarrëse në kuadër të fushatës “16 Ditë aktivizëm kundër dhunës me bazë gjinore” në Kamenicë, OJQ “Lulludi” në bashkëpunim me Njësinë Komonale për të Drejtat e Njeriut dhe me mbështetjen e OSBE-ka mbajtur punëtorinë sensibilizuese me temën “Dhuna në familje me 50 të rinjtë e komunitetit Rom”, edhe Bashkësia Islame mblodhi Institucione të ndryshme për të diskutuar Kundër Dhunës ndaj Gruas, janë mbajtur sesione informues me nxënës të shkollave të mesme të komunes në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore”, ka treguar ajo duke thënë se kjo fushatë nuk do të vazhdoj vetëm 16 ditë por tërë vitin.


Pika IV

Të ndryshme

Sherefedin Vranja përfaqësues i OJQ-ve, ngriti shqetësimin e mos pagesës së mëditjeve për anëtarët e KKS-së, dhe kërkoje zgjidhje !

Hyrmete Morina përfaqësues e komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, ngriti shqetësimin që ende nuk janë akomoduar si OJQ me zyre dhe njoftoi se kanë gjetur një zyre por duhet intervenuar

Procesmbajtës:


Fisnik Kastrati

Kryetari i Komunës


Kadri RAHIMAJ